



Funded by
the European Union

Rinegocim i pozitës së komuniteteve LGBTI+ në hapësirën publike

2024

Implementuar nga:



QENDRA PËR BARAZI DHE LIRI TË KOMUNITETET LGBT NË KOSOVË (CEL)

COPYRIGHT © CENTRE FOR EQUALITY AND LIBERTY TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA. ASNJË PJESE E KËTIJ PUBLIKIMI NUK MUND TË RIPRODHOHET, TË RUHET OSE TË TRANSMETOHET NË ÇFARËDO FORME ELEKTRONIKE, MEKANIKE FOTOKOPJUESE, INCIZUESE APO NDRYSHE, PA LEJEN PARAPRAKE TË CEL KOSOVA.

CEL. Tel: +383 49 701 499
e-mail: info@cel-ks.org
web-page: www.cel-ks.org

Klauzola e përgjegjësisë

Ky publikim u financua nga Bashkimi Europian. Përmbatja e tij është përgjegjësi e vetme e CEL Kosova dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Europian.

Rinegocim i pozitës së komuniteteve LGBTI+ në
hapësirën publike - Prishtina si ksenotopi

Hulumtues

Agnesa Bytyci dhe Miranda Mehmeti

Mentor

Ass. Dr. Artan Krasniqi

Universiteti i Prishtinës,
Fakulteti Filozofik,
Departamenti i Sociologjisë.
dhjetor, 2024

A është hapësira publike gjithmonë dhe për të gjithë publike? Personat LGBTI+ në Prishtinë e shkundin në thelb këtë pyetje. Atyre shpesh u duhet që të ndrydhin ose të fshehin identitetet e tyre, në kundërvlerë të sigurisë së tyre, edhe në hapësira publike. Mbase, më pak i ditur është fakti se veçanërisht personat trans shmangin ecjen në zona të tëra të qytetit. Ky grup nuk janë kategoria e vetme që mund ta ndiejnë këtë rrezik, një rrezik që bëhet evident nga rritja e vazhdueshme e sulmeve mizogjene dhe krimeve të urrejtjes të shprehura në forma të ndryshme.

Mes dyzimit të sferave jetësore në ato private dhe publike, komuniteti queer në Prishtinë ka krijuar gjithmonë hapësirat e veta të sigurta. Një hartëzim aktual i prezencës queer shpërfaqë një përqendrim të dukshëm të saj në pozita qendrore të qytetit, si nga parada e krenarisë që organizohet çdo vit që nga 2017-ta, queer pub-i Bubble, ngjarjeve kulturore (drag shows, ekspozita me tematika queer) të organizuara në Grand Hotel Prishtina nga organizata Sehmet, kolektivi Hyjneshat, e shembuj të tjerë. Para kësaj, jeta sociale e komuniteteve kufizohej dhe varej në të shumtën e rasteve nga hapësirat krejt private që ata mund të gjenin. Kështu, historia frymëzuese e Qerkicës dhe Mustafës na dëshmon se si që nga viti 2003 ata hapën dyert e shtëpisë së tyre për individë të komuniteteve LGBTI+, të mbetur pa strehë për shkak të dhunës psikike e fizike nga rrethi ku jetonin. Shtëpia e tyre u shndërrua edhe në vend ku anëtarët e komuniteteve LGBTI+ thjesht mund të mblidheshin për të qenë vetvetja.

Por, si mund të paramendohet ndryshe ndërveprimi i qytetit me komunitetet?

Ky artikull fokusin e ka tek eksplorimi i raportit mes komuniteteve LGBTI+ dhe hapësirave publike në Prishtinë, duke ofruar nocionin e *ksenotopisë* për rikonceptualizimin queer të hapësirës si shënim i realitetit të ri. Ky teorizim, i

frymëzuar nga lëvizja intelektuale e *kthesës hapësinore* që përfshin *heterotopinë* e Michel Foucault, do të mbështetet nga shembuj praktikë të rasteve të shpërfaqjes queer në publik, reagimeve që kanë ngjallur dhe kujtesës publike ndaj saj. Më pas, do të shtrohet në pyetje se sa të sigurt janë këto hapësira në të vërtetë, për ta përmbyllur me një krahasim mes Prishtinës me qytetin e Berlinit.

Kthesa hapësinore si mjet për rimendim queer të hapësirës

Në tre dekadat e fundit, një lëvizje intelektuale e quajtur “kthesa hapësinore” (angl.: spatial turn), term i cili përdoret së pari nga Edward Soja (1989), ka qenë pikë interesi e shkencave shoqërore dhe e atyre humanistike. Rritja e perspektivës hapësinore premtun një kuptim më të saktë të kompleksitetit të fenomeneve dhe lidhjeve shoqërore dhe në të njëjtën kohë një aftësi më të theksuar për të vepruar dhe formësuar gjërat në një kuptim profesional shkencor. Hapësira përsëri perceptohet si një variabël apo konstrukt social dhe kulturor. Shtrohet nevoja për një fokus të ripërtirë të konceptimit mbi hapësirën, i cili nuk e sheh më hapësirën vetëm si një “kontejner” në të cilën ndodhen grupe njerëzish dhe kulturash. Në vend të kësaj, hapësira tani shfaqet si rezultat i marrëdhënieve shoqërore që lindin nga interesat

dhe veprimet e njerëzve ose grupeve individuale; hapësira natyrore (ose reale) plotësohet nga perceptimi ose krijimi hapësinor i formës shoqërore dhe kulturore që është dominues për subjektin.

“Zgjerimi i saj në të ardhmen, megjithatë, ka potencialin të jetë një nga zhvillimet më domethënëse intelektuale dhe politike të shekullit të njëzet e një” (Soja 2009, 12).

Edhe këtu mund të vërehen prapë tendenca për të paralajmëruar gjithmonë kundër një esencjalizimi apo substancializimi të hapësirës, tendencë kjo e ngurtësuar nga veprat e hershme rreth kthesës hapësinore, veçanërisht në ato që lanë pas fushën e gjeografisë dhe të sociologjisë “tradicionale”. Sipas kuptimit që i jep gjeografia britanike Doreen Massey, hapësira ndërtohet nga marrëdhëniet. Kjo do të thotë të kuptosh hapësirën si “bashkëjetesë simultane të marrëdhënieve shoqërore, që nuk mund të kuptohet ndryshe përveçse në mënyrë dinamike” (Massey 1994, 120).

Për filozofin francez Michel Foucault, sipas një teksti të shkurtër të tij në vitin 1967, shekulli i 19-të ishte i obsesionuar pas historisë dhe kohës, ndërsa shekulli i 20-të është një epokë e hapësirës. Se sa ka pasur ndikim në rimendimin queer të hapësirës, tregon edhe stërpërdorimi i konceptit të tij mbi “heterotopitë” në teorizimin e çështjeve queer. Të dyja këto koncepte mbështeten në qasjen konstruktiviste në sociologji, për të qenë kritikë ndaj asaj që ata i konsiderojnë pikëpamjet esencjaliste. Ndërkaq, në përpjekje për tu larguar nga mbingarkesa e “heterotopisë” (në kuptimin e ngushtë të fjalës, çdo vend mund të përkufizohet si heterotopi), ne po marrin hapin mbase të guximshëm të propozojmë përdorimin e nocionit “ksenotopia” jo si diçka tërësisht e re, por si një kahe e re për konceptimin queer të hapësirës. Këtë do ta shtjellojmë më tej.

Nga heterotopia tek kseonotopia – Prishtina si ksenotopi

Heterotopitë, siç i shtjellon Michel Foucault në *Of Other Spaces* (1967), janë hapësira institucionale dhe diskursive që janë të gdhendura me shtresa të shumëllojshme kuptimi që krijojnë njëkohësisht (dhe paradoksalisht) vende të “tjetrit”; këto janë hapësira të cilat janë kontradiktore dhe të papajtueshme në lidhje me dinamikën normative të pushtetit të qytetit. Foucault vëren se për t’i shpëtuar shtypjes në jetën e përditshme, krijimi i hapësirave heterotopike është i nevojshëm në mënyrë që individët të mund të fillojnë të shprehin dallimet e tyre themelore. Foucault identifikon heterotopitë në hapësirat intime si shtëpitë publike dhe banjat, por edhe varrezat, bibliotekat dhe motelet, të cilat janë qartësisht të ndara nga hapësirat e jetës së përditshme, dhe megjithatë janë ende në një marrëdhënie të ngushtë, të lidhur me to.

Foucault pohon se “hapësira bashkëkohore ndoshta nuk është ende plotësisht e çshenjtëruar”, por ende mbart me vete kundërshtimet e hapësirës private dhe publike, hapësirës familjare dhe shoqërore, hapësirës kulturore dhe të dobishme, si dhe hapësirës së kohës së lirë dhe punës. Sipas Foucault, qëndrueshmëria e këtyre kundërshtimeve lë të kuptohet për praninë e fshehur të së shenjtës. Hapësira bashkëkohore e vendeve për Foucault është shumë heterogjene, jo një zbrazëti e pafund homogjene që pret të plotësohet. Midis utopisë dhe heterotopisë, Foucault e pozicionon figurën e pasqyrës. Përvoja hibride e pasqyrës është njëkohësisht utopike dhe heterotopike. Aspekti utopik i

tij si një “vend pa vend” i mundëson subjektit të shohë veten në një vend ku nuk është; por ka edhe një aspekt heterotopik për atë që pasqyra ekziston në realitet.

Një trend tjetër përdorimi ka nocioni “ksenotopia” që deri tani përdoret pak herë dhe me përkufizim jo atë që etabluar dhe fluid. Andaj, në orvatjen tonë, kuptimi që i japim ksenotopisë është vend ku sfidohen dhe përplasen “pseudo-tjetra” me “pseudo-tonën” në hapësirën publike, që me terma të Massey mund të quhet “bashkëjetesë simultane e marrëdhënieve shoqërore”. Duhet vënë në pah se përdorimi i termit “kseno” (greq. i/e huaj) këtu nuk ka kuptimin përjashtues të “të huajës” apo ekzoticizimit të saj, por është një përzgjedhje e qëllimshme për përvetësimin e narrativës dhe heqjen nga huajësia. Fundja, edhe termi “queer” historikisht është përdorur në mënyrë përbuzëse, deri në vendimin e vetëdijshëm për përdorimin e tij si pjesë e luftimit të sfidave të komuniteteve LGBTI+.

Ksenotopia është vend që shënon një realitet të ri, të rrënjosur në vendosmërinë e sfidimit dhe ballafaqimit me heteronormativitetin e hapësirës. Tek ksenotopia ndodh edhe “beteja” e narrativave të memories publike, duke pyetur sesi historiografitë anti-hegjemoniste, praktikantët e projektimit dhe prodhimet e njohurive (Haraway 1988; Ahmed 2017) mund ta transformojnë ruajtjen e trashëgimisë në një formë queer. Ksenotopia synon të shqyrtojë hapësirat e padukshme ose të anashkaluara në mënyrë aktive – ato që, për shkak të strukturave të pushtetit historik dhe patriarkal, janë të stigmatizuara ose të heshtura shoqërisht. Ne ndajmë besimin se hapësira e sigurt nuk është vend i izoluar, një “fluskë”, por një hapësirë ndërveprimi.

Urbanizmi Queer

Nëse strukturat heteronormative dhe patriarkale janë të gdhendura në arkitekturën ekzistuese, si do të dukeshin metodat praktike që çmontojnë këta mekanizma? Frymëzuar nga koncepti i Audre Lorde tek *Dismantling the Master's Tools*, qasjet e reja multidisiplinare mundësojnë forma alternative të projektimit hapësinor, praktikës hapësinore dhe prodhimit arkitektonik. *Si mund të ndërhyjmë në strukturat ekzistuese urbane kur lexojmë arkitekturën e ndërtuar si një arkiv të historive patriarkale? Cilat mjete janë të përshtatshme për këtë qëllim dhe si mund të marrim njohuri nga disiplina të tjera për të zhvilluar metoda të reja projektimi?*

Siç e përvijon Thomas Stempka, atë që ne tani e quajmë Urbanizëm Queer i ka themelet në ekspozitën Queer Space të vitit 1994 në *Storefront for Art & Architecture* në *New York City*. Krijuesit dhe kuratorët e ekspozitës ngritën pyetje për hapësirat ku ne jetojmë: "Si mund t'i përcaktojnë minoritetet të drejtat e tyre për të zënë hapësira brenda qytetit? Si mund të legjitimohet një hapësirë e tillë, duke i dhënë një histori dhe një të ardhme? A është edhe hapësira fizike që është në pyetje, apo është hapësira e praktikave diskursive, teksteve, kodeve të sjelljes dhe normave rregullatore që organizojnë jetën shoqërore?" (Storefront 1994). Rreth 15 vjet më vonë fraza "Queer Urbanism" (Goh 2011) do të aktualizohej, pasi disa organizata në New York (të tilla si FIERCE, Q-wave, Queers for Economic Justice dhe Audre Lorde Project) filluan të luftojnë kundër hierarkisë heteronormative të urbanistikës.

A është prezenca publike e komuniteteve LGBTI+ e barasvlefshme me sigurinë e tyre?

Konteksti kosovar është shumë i rëndësishëm kur flasim për kalimin e prezencës queer nga hapësira private në atë publike. Sot, me gjithë përmirësimet evidente, ende ekziston një betejë mes grupeve “konservatore” dhe komuniteteve. Janë të shumtë artikujt të cilët detajojnë sfidat e organizimit LGBTI+ në hapësirat publike.

Në artikullin e saj për *Kosovo 2.0*, Seyward Darby tregon për raste të po këtij tentimi të organizimit queer. “Pure Pure” ishte një klub i cili u mundua të sjellë një klientelë të re, ku një punëtor filloi të reklamojë klubin si një hapësirë miqësore për komunitetin queer. Një portal lajmesh kishte dërguar një fotograf për të vizituar klubin dhe më vonë, disa fansa të futbollit erdhën për të shkaktuar probleme. Sipas artikullit të Darby-t, punëtori i cili vendosi thirrjen në internet u largua nga puna. Punëtori u largua nga puna dhe ishte zbuluar si homoseksual. Ky punëtor nuk gjendet më në Kosovë (Darby, 2012).

Raste si ky mund të kenë ndjell frikë e rrjedhimisht kanë sjell në stagnimin dhe strukjen e këtyre komuniteteve në raport me shpërfaqjen në hapësira publike. Megjithëkëtë, *Prishtina Pride* mund të jetë shembulli i anës tjetër që flet për një kapërcim gradual nga hapësira private në atë publike, me poentën e saj qendrore - shfaqjen e krenarisë dhe qëndrueshmërisë së komuniteteve LGBTI+. *Sheshi i Krenarisë* ishte një aksion simbolik i krijuar para Hotelit Grand, ku në qershorin e vitit 2024 zebtrat ishin ngjyrosur me ngjyrat e ylberit. Kjo na dha të kuptojmë se kalimi drejt publikes nuk kufizohet nga prezenca e trupave fizikë dhe se jo me çdo

kusht duhet të jetë personi ai që zë një vend në hapësirë. Këto hapa, pa kurrfarë befasi, nxitën reagime nga grupet homofobe në Prishtinë. Sheshi i Krenarisë do të vandalizohej pak kohë pasi që do të shfaqej, me mesazhe homofobike të bëra mbi të. Aktivistë të iniciativave të ndryshme queer dhe aleatë të tjerë kundër-reaguan duke fshirë mesazhet, e duke shkruar po mbi zebra mesazhin: “poshtë homofobia, bifobia dhe transfobia” (Dylberizëm, 2024).

Sigurisht, angazhimi nuk vjen vetëm nga organizatat. Ermira Murati, ndryshe e njohur si Orange Girl, në vitin 2022 pikturon muralin e Qerkicës, një gruaje trans, dhe Mustafës, mikut të saj të ngushtë. Ky çift ishin pjesë në dokumentarin *Kah kqyrsha përjetë, e shifsha vetën përfuni*, një dokumentar që rrëfeu për jetën e disa personave queer në Kosovë. Ky mural, me pozicionimin e tij, në kampusin e Universitetit të Prishtinës, aty te Fakulteti Filozofik dhe ai i Filologjisë, nxiti reagime të menjëhershme. Këtu mund të themi se personat queer janë prezantuar në një hapësirë tejet publike, që si e tillë shërben si një forum ku ballafaqohen të kundërtat.

Fatkeqësisht, as kjo vepër arti nuk u kursye nga sulmet homofobike. Sipas Muratit, murali u vandalizua pak kohë pasi që përfunduar. Dy persona kishin përdorur ngjyrë të përzier më ujë, një kombinim që garanton përhapje sa më të madhe, me poentën e dëmtimit të portreti të Qerkicës dhe Mustafës. Një vandalizim, tanimë i fshirë, e ndjek muralin një vit më vonë, me tekstin “Fuck LGBTQI+” (v.j. i shkruar madje gabimisht nga vandalizuesit). Në një bashkëbisedim, Murati këtë e komenton si “ekzistim i dy realiteteve kosovare në një vend, rrjedhimisht, një pranim i flaktë dhe një denoncim i egër” (2014).

Me rritje të vazhdueshme të fitoreve të krahut politik të djathtë, komunitetet LGBTQIA+ në shumë vende janë duke e shmangur hapësirën publike. Vende si SHBA-të, vetëm se janë duke parë rritje të kërcënimeve ndaj personave queer

dhe pozitës së tyre në shoqëri. (Ludwig, 2023.) Megjithatë Kosova ka shumë punë për të bërë, pavarësisht disa përmirësimeve të vogla. Hapësira publike duhet të kalojë përmes një tranzicioni të ngadalshëm dhe të qëllimshëm, në mënyrë që asgjë të mos mbetet në margjinat e të “pranueshmes” dhe të “papranueshmes”.

Një qasje krahasimtare - Prishtinë dhe Berlin

Një hapësirë nuk përjashtohet as nga ndikimi i veprimtarisë politike. Publikja dhe privatja, sikurse klasa, gjinia, orientimi seksual, raca etj, janë aspekte identitare dhe politike që e formësojnë hapësirën. Ekzistenca queer në Kosovë duhet të ballafaqohet me një jetesë të kufizuar brenda hapësirave që duhen të jenë të hapura për të gjithë, dhe nuk është e pazakontë që ata ta lëshojnë Kosovën për vende më mikpritëse. Shtetet perëndimore janë këto strehë të sigurta.

Berlini, si kryeqytet i Gjermanisë dhe metropol, sot ka një variacion të hapësirave queer në lagjet e veta. Por edhe në historinë e tij të gjerë si qytet, Berlini ka historitë queer të ngulitura në muret, kalldrëmet dhe shtigjet e qytetit. Në Tiergarten të Berlinit, njerëzit mund të vizitojnë një nga memorialet e viktimave queer (ose homoseksualë) të Holokaustit. Edhe pse këto përkujtime janë kritikuar për vonesën e tyre, populli gjerman ka nisur t'i përfshijë edhe komunitetin homoseksual (queer) në përkujtimin e viktimave të regjimit nazist (Chimbelu, 2023).

Berlini dhe, rrjedhimisht, shumë qytete të tjera perëndimore janë strehë të sigurta që janë përmendur më lartë. Në një bisedë të zhvilluar me një djalë që ka kërkuar të mbetet anonim, ai shprehu se ishte njoftuar me skenën queer

berlineze përmes internetit. Ai citoi ndjenjën e liritimit kur kuptoi për ekzistencën e këtyre hapësirave dhe ndau që nuk përjetoi aspak "culture shock" kur i vizitoi fizikisht herën e parë.

Kontrasti tjetër vjen nga disponueshmëria e hapësirave. "Bubble pub" është i vetmi vend në qytetin e Prishtinës i cili është themeluar nga dhe për komunitetet LGBTI+. Homofobia vjen edhe në formë të mos aprovimit të shfrytëzimit të hapësirave nëse paramendohet se do të jetë një vend për personat queer. Megjithëse kanë kaluar dy vite nga hapja e tij në zonën qendrore të qytetit të njohur si "kafet e rakisë" dhe të përzier për nga audienca, ende është aktuale nevoja e diskutimit për rolin që ka ky pub në të qenurit "ksenotopi" e mirëfilltë.

Referencat

- Ahmed, Sarah (2017), "Living a Feminist Life", Duke University Press.
- Darby, S. (2012, Dhjetor 14). *Homofobia në Kosovë*. Qasur me Nentor 19, 2024, nga <https://kosovotwopointzero.com/kosovo-homophobia/>
- Dylberizëm. (2024, Qershor 7). Vandalizohet "Sheshi i Krenarisë" me mbishkrime homofobike. Qasur me Nentor 19, 2024, nga https://www.dylberizm.com/2024/06/07/p_w_5/
- Foucault, Michel (1986 [1967]), "Of Other Spaces", *Diacritics* 16, 22 – 27
- Goh, Kian. "From and Toward a Queer Urbanism". Planners Network, April 4, 2011. <https://www.plannersnetwork.org/2011/04/from-and-toward-a-queer-urbanism/>. Qasur më 20 nëntor 2024.
- Haraway, Donna (1988), "Situated Knowledges: The Science Question in Feminism and the Privilege of Partial Perspective" *Feminist Studies* 14, no. 3.
- Lorde, Audre (1984) "The Master's Tools Will Never Dismantle the Master's House." *Sister Outsider: Essays and Speeches*.
- Ludwig, M. (2023, Qershor 21). *Survey: 61% of LGBTQ People Have Avoided a Public Space Due to Fear of Violence*. Qasur me Nentor 19, 2024, nga <https://truthout.org/articles/survey-61-of-lgbtq-people-have-avoided-a-public-space-due-to-fear-of-violence/>
- Massey, Doreen (1994), *Space, Place, and Gender*, University of Minnesota Press.
- Soja, Edward (1989), *Postmodern Geographies: The Reassertion of Space in Critical Social Theory*, Verso.
- Murati, Ermira, interview by Agnesa Bytyqi. 2024. (Nentor 14).